

VENDIM
Nr. 10/2012

**PËR LIRIMIN E ZONJËS ENKELEDA SHEHI NGA DETYRA E NËNKRYETARIT TË
BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE NË POZICIONIN DREJTUES
I DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES DHE DISIPLINIMIT DHE ZGJEDHJEN E SAJ NË
DETYRËN E KRYETARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 8 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Enkeleda Shehi lirohet nga detyra e Nënkyetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit.
- II. Zonja Enkeleda Shehi zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 16.2.2012